



TV FESTINA
Besnik BERISHA
Drejtor
Ferizaj

Ankesa Nr. 2017/217 KPM vs TV FESTINA
Ref:1711/1279/KPM/am

VENDIM

Lidhur me Ankesën nr. 2017/217– Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) kundër TV FESTINA (“Pala Përgjegjëse”)

Faktet

1. Pala Përgjegjëse është pajisur me Licencë të KPM-së me datën 28 gusht 2009. Pranimi dhe nënshkrimi i Licencës obligon të Licencuarin që të veprojë në përputhje me Ligjin Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe me të gjitha aktet nënligjore të miratuara nga KPM.
2. KPM me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës Përgjegjëse me Ligjin e KPM-së dhe Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencë, ka realizuar një verifikim dhe në bazë të listës së publikuar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka konstatuar se Pala Përgjegjëse është në listën zgjedhore si kandidat për kryetar të Komunës së Ferizajt për Zgjedhjet Lokale 2017.
3. KPM me datën 27 shtator 2017 i ka dërguar Shkresë Palës Përgjegjëse, duke e njoftuar për shkeljen e Ligjit të KPM-së.
4. KPM me datën 5 tetor 2017 Palës Përgjegjëse përmes e-mail i ka dërguar format e parapara për ndryshime në licencë, mirëpo Pala Përgjegjëse ka dështuar t'i sjellë format e plotësuar për ndryshimin e pronësisë në KPM. Me datën 16 tetor 2017 KPM ka kontaktuar Palën Përgjegjëse përmes telefonit, ku është biseduar lidhur me këtë çështje.
5. KPM pas dërgimit të Shkresës dhe formave të parapara për ndryshime të licencë, me datën 6 tetor 2017, ka pranuar një përgjigje përmes e-mail nga Pala Përgjegjëse, me anë të së cilës pretendon se ka filluar procedurat për ndryshim të pronësisë, gjë të cilën nuk e ka bërë, sepse KPM nuk ka pranuar asnjë dokument për ndryshim të pronësisë nga Pala Përgjegjëse

6. Në bazë të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës neni 15, paragrafi 2, heqja dorë nga pronësia mund të prodhoj efekt ligjor vetëm atëherë kur aprovohet paraprakisht nga KPM-ja. Bazuar në faktin së KPM deri më tani nuk ka aprovuar ndonjë kërkesë të Palës Përgjegjëse për heqjen dorë nga pronësia, konsiderohet se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 22, paragrafi 3 pika 3.1 të Ligjit të KPM-së.

Analiza Ligjore

7. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 22, paragrafi 3, pika 3.1 të Ligjit të KPM-së.

Neni 22, paragrafi 3, pika 3.1 i Ligjit të KPM Nr. 04/L-44 përcakton se:

"Licenca e transmetimit nuk i lëshohet ose nuk do të vazhdoj t'i jepet:

partisë politike, bashkësisë fetare, grupit ose organizatës e cila menaxhohet nga individi cili mban post të zgjedhur ose është anëtar i një organi ekzekutiv të një partie politike;"

8. Komisioni duke u bazuar në faktet e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse ka dështuar të veprojë në pajtueshmëri me nenin 22, paragrafi 3, pika 3.1 të Ligjit të KPM-së, pasi që pronari i këtij subjekti transmetues është përfshirë në aktivitet politik.
9. Komisioni konstaton se Pala Përgjegjëse ka dështuar që të marrë hapa të nevojshëm për të vepruar në pajtueshmëri me nenin 22, paragrafi 3, pika 3.1 të Ligjit të KPM-së Nr. 04/L-44.

Vendimi


10. Komisioni bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 22, paragrafi 3, pika 3.1 të Ligjit të KPM-së.
11. KPM kërkon nga Pala Përgjegjëse që në afat prej 10 ditësh nga pranimi i këtij Vendimi të njoftojë zyrtarisht KPM-në për përcaktimin e tij nëse do të vazhdojë të jetë pronar i subjektit të licencuar dhe të heqë dorë nga aktiviteti politik, apo vazhdon të jetë i angazhuar me aktivitete politike, dhe të iniciojë procedurat për ndryshim të pronësisë së licencës. Përfshirja e Palës Përgjegjëse në aktivitete politike dhe në të njëjtën kohë të jetë pronar i OSHMA-së së licencuar nga KPM përbënë shkelje të Ligjit të KPM-së, që rezulton me ndërprerje të Licencës së KPM-së, ashtu siç është përcaktuar me nenin 30, paragrafi 1 pika. 6, i Ligjit të KPM-së.
12. Komisioni bazuar në nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së sanksionon me **Vërejtje** Palën Përgjegjëse për shkelje të nenit 22, paragrafi 3, pika 3.1, të Ligjit të KPM-së.

E drejta për Ankesë

13. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së.

Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.

14. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Adnan MEROVCI
Kryetar



08.11.2017
Datë